


BULETINI



NR. 6 | TETOR – DHJETOR 2019 |



Buletini Informues Cens 2020 shërben si pasqyrë e aktiviteteve kryesore që INSTAT ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë deri në përfundim të këtij projekti. Ai shpërndahe me frekuencë tremujore. Në numrin e gjashtë të buletinit paraqiten aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2019 dhe çfarë pritet të ndodhë gjatë muajve në vijim.

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë Cens-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2020. Cens-i i Popullsisë dhe Banesave 2020 do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë universale bazuar në operacionet në terren me plotësimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur teknika të reja për mbledhjen e të dhënave.

KONTAKT:

NR. JESHIL: **0800 22 44**

EMAIL: **CENS2020@INSTAT.GOV.AL**

PËRMBAJTJA

Aktivitetet e CENS 2020, Tetor-Nëntor-Dhjetor 2019

- Zhvillimi i pilot të Censit
- Fushata e komunikimit për pilotin e Censit
- Takime me përfaqësues të Bashkive
- Strategjia e Komunikimi të Cens 2020
- Përgatitja e hartave për Cens 2020
- Zhvillimi i aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin
- Trajnimi i stafit për pilotin e Censit
- Vizitë studimore në kuadër të Cens 2020
- Monitorimi i mbledhjes së të dhënave të pilotit
- Aktivitetet e parashikuara për periudhën Janar-Mars 2020



Zhvillimi i pilot të Censit



Në datën 21 Tetor 2019 filloi numërimi në terren i popullsisë dhe banesave për fazën pilot të Censit. Për këtë fazë u përzgjedhën 10 Bashki, që mundësuan testimin e metodologjisë, sistemin e teknologjisë së mbledhjes së të dhënave si dhe të gjitha procedurat që planifikohen të ndiqen në Cens 2020.

Bashkitë, në të cilat u zhvillua piloti i Censit janë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Himarë, Shkodër, Malësi e Madhe, Kukës, Maliq, Pustec, Kolonjë, duke përfshirë 100 zona numërimi, nga të cilat 52 zona urbane dhe 48 zona rurale, në një total prej 7,000 njësi ekonomike familjare dhe dy institucione kolektive.

Stafi i mbledhjes së të dhënave në terren u asistua në mënyrë të vazhdueshme nga stafi mbështetës i teknologjisë së informacionit për problematikat lidhur me punën me tableta, si edhe nga stafi i INSTAT lidhur me plotësimin dhe vlerësimin e pyetësoreve.

Faza e pilotit në terren zgjati deri më 30 Nëntor 2019. Mbledhja e të dhënave u realizua në mënyrë elektronike nëpërmjet tabletave.

Fushata e komunikimit për pilotin e Censit

Gjatë periudhës Tetor - Nëntor 2019, INSTAT ka finalizuar dhe shpërndarë materialet informuese për pilotin e Censit.

Në këtë kuadër anketuesit u pajisën me bexhe, çanta dhe distiktivë me logot e INSTAT dhe Cens 2020, si edhe me fletëpalosje, të cilat u shpërndan te familjet e anketuara. Fletëpalosjet përmbajnë informacione të detajuara, duke u përgjigjur 4 pyetjeve: ÇFARË është Censi i Popullsisë dhe Banesave, ÇFARË është dhe KUR do të zhvillohet Piloti i Censit, PSE është i rëndësishëm dhe SI mbrohen të dhënat.

ÇFARË është Censi i Popullsisë dhe Banesave?
 Vendet e të gjithë botës kryejnë çdo 10 vjet regjistrimin e popullsisë dhe banesave. Secili shtet ka vendet në shtet në çdo dekadë për të numëruar në mënyrë të plotë çdo banor dhe banesë të territorit të vet.
 Shqipëria ka zhvilluar Censin e parë të Popullsisë dhe Banesave në vitin 1930 të ndërmjet të ekspertëve austriakë të statistikave, Franz Selner. Më pas Censin e parë të popullsisë i kryer nga shteti shqiptarë daton në vitin 1923, dhe vijuar me vitet 1930, 1950 etj., deri në Censin e fundit në vitin 2001. Vit 2020 është më e fundit që Shqipëria do të zhvillojë Censin e të të të të, i cili përfshihet dhe kryhet në mënyrë të përvetësuar nga Institut i Statistikave të Shqipërisë.

PSE është i rëndësishëm?
 Anyeja për kryerjen e Censit i Popullsisë dhe Banesave është që t'u ofrojë përdoruesit të dhëna të besueshme statistike, të nevojshme për planifikimin dhe regjistrimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për vlerën private e publike të vendmarrjes, të rritjes shkollore dhe, në përfundim, për përmirësimin e njohjes e të kushtuar nga shtetësit të rezultateve demografike, ekonomike dhe shoqërore të vendit.

ÇFARË është dhe KUR do të zhvillohet Piloti i Censit?
 Piloti i Censit është një proces gjithëpërfshirës dhe kryhet një vit përpara Censit real. Piloti i Censit do të zhvillohet më 21 Tetor 2019 dhe do të kryhet në 10 bashki të zgjedhura si zona specifike të cilat janë Durrës, Himarë, Kolonjë, Malësi e Madhe, Kukës, Maliq, Pustec, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Dëllimi kryesor i Pilotit të Censit është që të provohet në kushte reale hartagjerë, metodologjia, strukturën organizative, sistemin kompjuterik CAP (Computer Assisted Personal Interview), planifikimin logjistik dhe ndërveprimin midis të gjithë bashkëve të planifikuar për t'u angazhuar në vendet regjistruar aktual.

SI mbrohen të dhënat?
 Të dhënat e mbledhura për Cens 2020, trajtohen si konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime statistike mbështetëse në ligjin nr. 17/2018 "Për Statistikat zyrtare".
 Të dhënat personale të mbledhura në kuadër të Censit 2020 janë subjekt i ligjit nr. 5887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Për përfundim të çështjes, të dhënat ruhen, sigurohen dhe lidojnë në mënyrë që asnjë të mos ketë mundësi t'i shohë.



Takime me përfaqësues të Bashkive

Përgjatë muajit Tetor dhe fillimit të muajit Nëntor, njësitë përgjegjëse për zbatimin e Censit në INSTAT kanë realizuar takime me përfaqësues të Bashkive ku po zhvillohej Piloti i Censit. Qëllimi i këtyre takimeve ishte mbështetja dhe njohja e rëndësisë së zbatimit të Cens 2020. Gjatë takimeve të zhvilluara, Bashkitë janë njohur me fazën aktuale të pilotit të Censit dhe për hapat e mëtejshme që do të ndiqen.

Strategjia e Komunikimit për Cens 2020

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019 u hartua Strategjia e Komunikimit për Cens 2020, nga eksperti i Asistencës Teknike të BE-së. Strategjia e komunikimit do të përcaktojë aspektet e ndryshme në lidhje me zbatimin e fushatës së komunikimit dhe do të strukturojë një plan aktivitetesh: modulimin dhe kohëzgjatjen e fushatës, orarin dhe frekuencën e transmetimeve në radio dhe televizionin dhe publikimin e inserteve të gazetës, përmbajtjen e mesazheve, etj.

Përgatitja e hartave për Cens 2020

Njësia e Gjeo-informacionit ka mbështetur Pilot Censin, që nga përgatitja e gjeo-databazës deri në përgatitjen e hartave dhe ofrimin e ndihmës për anketuesit e pilotit të Censit. 100 Zonat e Pilotit u zgjedhën dhe u përditësuan me përparësi nga stafi i GIS në terren. Pas punës në terren, zonat e Cens (ZC) të zgjedhura u kontrolluan (në terren dhe zyrë), u pastruan dhe u kodifikuan në zyrë sipas rezultateve nga terreni.

Hartat e zonave të Censit për anketuesit e pilot u përgatitën dhe u ngarkuan në tableta. Gjithashtu, njësia e GIS ka ndihmuar dhe mbështetur anketuesit e pilotit, për orjentimin e tyre në terren gjatë fazës së regjistrimit sipas kërkesave të tyre. Paralelisht, vijoi puna me përditësimin e hartave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përditësimi i ndërtesave dhe banesave ishte planifikuar të finalizohet për të gjithë vendin, në fund të muajit dhjetor 2019, duke përfshirë të gjithë zonat e Censit në Shqipëri. Nisur nga situata dhe ndryshimet e ndodhura në terren, të shkaktuara nga tërmeti, lindi nevoja e vazhdimit të përditësimit të ndërtesave dhe banesave edhe gjatë vitit 2020, në zonat e prekura. Procesi i përditësimit të këtyre zonave do të jetë në një fazë të dytë gjatë vitit 2020, pas vlerësimit zyrtar të zonave të prekura nga tërmeti.

Zhvillimi i aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave dhe për monitorimin

Në muajin Tetor, INSTAT në bashkëpunim me ekspertët e Asistencës Teknike të BE-së, finalizuan aplikacionin CAPI (Intervistimeve Personale me Ndihmën e Kompjuterit) për mbledhjen e të dhënave me anë të platformës Survey Solution, e cila është një platformë e ndërtuar nga Banka Botërore për të zhvilluar aplikacione për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike. E njëjta platformë u përdor edhe për aplikacionin e monitorimit të kontrollorëve. Ky aplikacion shërben për kontrollin gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave në terren dhe përbëhet nga disa forma raportimi:

- Raporti nëpërmjet të cilit kontrollohet progresi i intervistave të anketuesve;

- Raporti që lejon analizimin e cilësisë së intervistave të kryera nga anketuesit.

Nëse intervista e kryer nga anketuesi është plotësuar në mënyrë korrekte, kontrollori e aprovon, në të kundërt, kontrollori e kthen intervistën tek anketuesi për korrigjimet e nevojshme.

- Raporti në lidhje me gjatësinë e intervistave
- Raporti i numrit të intervistave sipas ditëve.

Gjithashtu, u zhvilluan edhe aplikacionet e monitorimit të supervizorëve dhe stafit të INSTAT.

Gjatë muajit Tetor u finalizua edhe implementimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, i cili do të shërbejë për sinkronizimin e të dhënave të mbledhura në terren. Mbledhja e të dhënave me anë të sistemit CAPI lejon transmetimin e të dhënave nëpërmjet internetit.

Trajnimi i stafit për pilotin e Censit



INSTAT realizoi trajnimin e stafit që do të angazhohej në pilot Cens sipas metodës kaskadë. Në datat 7 - 11 Tetor 2019, u krye trajnimi i trajnerëve (stafi i INSTAT), supervizorët dhe kontrollorët të cilët më pas trajnuan anketuesit.

Gjatë fazës së parë të trajnimit, stafi INSTAT, supervizorët dhe kontrollorët u njohën me terminologjinë dhe metodologjinë e Cens, përdorimin e tabletave si dhe plotësimin e pyetësorit në mënyrë elektronike, punën me hartat, logjistikën dhe organizimin e punës gjatë mbledhjes së të dhënave, komunikimin, etikën, konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtjen e të dhënave.

Në datat 15 - 18 Tetor 2019 vijoi faza e dytë e trajnimit, i cili konsistoi në trajnimin e anketuesëve. Anketuesit u trajnuan nga supervizorët edhe kontrollorët e tyre nën mbikqyrjen e stafit të INSTAT.

Vizitë studimore në kuadër të Cens 2020



Gjatë muajit Dhjetor janë zhvilluar dy vizita studimore në kuadër të Cens 2020. Në datat 8 - 13 Dhjetor 2019, njësia e komunikimit të Cens 2020, e përbërë nga katër antarë, zhvilluan një vizitë studimore në Institutin e Statistikave të Çekisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja dhe diskutimi për zbatimin e planit të komunikimit për Censin e Popullsisë dhe Banesave. Në datat 16 - 18 Dhjetor 2019, në Irlandë u zhvillua vizita studimore mbi menaxhimin e granteve, raportimin dhe procedurat e auditimit në kuadër të Cens 2020. Vizitat studimore kishin për qëllim njohjen e praktikave më të mira dhe eksperiencën e vendeve evropiane.

Monitorimi i mbledhjes së të dhënave të pilotit

Mbledhja e të dhënave gjatë pilotit të Cens nga anketuesit dhe stafi i terrenit u monitorua në përditëshmëri nga punonjësit e zyrave të statistikave rajonale në qarqet ku u zhvillua piloti i Censit, si edhe nga zyra qendrore e INSTAT. Për procesin e monitorimit, INSTAT angazhoi 40 punonjës.

Më 24 Tetor, ekspertët e Asistencës Teknike të BE-së organizuan një vizitë monitoruese për stafin e terrenit në bashkinë Vlorë. Në fokus ishte diskutimi dhe shkëmbimi i eksperiencave mbi aktivitetet e terrenit, ecurinë e mbledhjes së të dhënave me tabletë, komunikimin me të anketuarit dhe raportimi i problematikave të punës në terren.

Ekspertët e Misionit të Monitorimit nga Komision Evropian, gjithashtu ishin të pranishëm në këtë proces, duke monitoruar drejtpërsëdrejti intervistat e anketuesëve në bashkitë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Himarë, Kukës, Pustec gjatë datave 21 - 31 Tetor, dhe 4 - 9 Nëntor, përfshirë edhe monitorimin e aspekteve organizative për pilotin.

Gjithashtu, ky proces u monitorua edhe nga donatorët. Përfaqësues të Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, morën pjesë gjatë zhvillimit të intervistave në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Tiranë.

Për fazën pilot u vendos një adresë specifike e-mail-i, ku u raportua mbi problematikat dhe progresin e punës në bazë ditore. Numri jeshil (falas) u instalua dhe ishte në dispozicion të të gjithë qytetarëve për sqarime dhe informim gjatë fazës pilot.

Aktivitetet e parashikuara për periudhën Janar-Mars 2020

Gjatë 3 mujorit të parë 2020, do të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:

- Analizimi i gjetjeve të pilotit për të gjithë proceset, teknologjinë e informacionit, metodologjinë, trajnimin, GIS, komunikimin, logjistikën dhe burimet njerëzore;
 - Planifikimi dhe përmirësimi i aplikacioneve të mbledhjes së të dhënave me anë të sistemit CAPI;
 - Kontrolli dhe digjitalizimi i të dhënave të gjeoreferuara të mbledhur në terren, punë përgatitore në kuadër të aktiviteve të Cens 2020;
 - Përgatitja e tabelave kryesore me të dhënat e pilot Cens, për qëllime të brendshme.
-